

ANEKSI 62-01

Fleta e informacionit INF 3 — kërkesat e të dhënave

Fleta e informacionit INF 3 do të përmbajë të gjithë njësitë e informacionit që kërkohen nga autoritetet doganore për qëllimin e identifikimit të mallrave të eksportuara.

A. PJESA PËR DEKLARUESIN

Kutia 1: Eksportuesi

Jepni emrin ose emrin tregtar dhe adresën e plotë.

Kutia 2: Marrësi

Kutia 3: Vendi ku dërgohen mallrat/destinacioni

Kutia 4: Numri, lloji, markat dhe numri i paketimeve dhe përshkrimi i mallrave të eksportuara

Jepni detaje të sakta për mallrat në përputhje me përshkrimin e tyre tregtar ose në përputhje me përshkrimin tarifor të tyre. Përshkrimi duhet të korrespondojë me atë të përdorur në deklaratën e eksportit.

Kutia 5: Pesha bruto

Jepni sasinë e shfaqur në deklaratën e eksportit.

Kutia 6: Pesha neto

Jepni sasinë e shfaqur në deklaratën e eksportit.

Kutia 7: Vlera statistikore

Jepni vlerën statistikore në kohën e eksportit.

Kutia 8: Sasia për të cilën kërkohet informacioni

Jepni detaje të peshës neto, volumit etj, të cilat personi i interesuar dëshiron t'i riimportojë, në shifra dhe fjalë.

Kutia 9: Kodi NK

Kutia 10: Informacion shtesë në lidhje me mallrat

Jepni detaje të dokumentit të eksportit: tipi, referenca dhe data. Tregoni nëse mallrat kanë lidhje me:

(a) mallra të eksportuar në përfundim të regjimit të përpunimit të aktiv;

(b) mallra të cilat janë çliruar për qarkullim të lirë për një përdorim specifik. Kjo njësi lidhet me mallrat të cilat janë çliruar për qarkullim të lirë në RSh, duke përfituar nga lehtësimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimet e importit për arsye të përdorimit të tyre për qëllime specifike.

(c) Mallra në një nga situatat e referuara në **Nenin 28(2) TFEU**. Kjo njësi lidhet me gjendjen e mallrave në kohën e eksportit të tyre.

(11) Kutia 11: Kërkesa e eksportuesit

Tregoni emrin dhe personin që nënshkruan fletën e informacionit. Shtoni datën, vendin dhe firmën

B. PJESA PËR AUTORITETET DOGANORE

(1) Kutia A: Nënshkrimi nga autoritetet përgjegjëse për liçensat e eksportit

Në rastin e mallrave të referuara në Nenin 138, Fleta e Informacionit INF3 mund të lëshohet vetëm me kushtin që kutia A të jetë plotësuar dhe nënshkruar më përpara nga autoritetet doganore, kur kërkohet informacioni i përmbajtur aty.

Shtoni datën, vendin dhe firmën.

(2) Kutia B: Nënshkrimi nga autoritetet përgjegjëse për rikthimin e pagesave ose shumave të tjera të siguruar për një eksport.

Në rastin e mallrave të referuara në Nenin 138, Fleta e Informacionit INF3 mund të lëshohet vetëm me kusht që kutia B të jetë plotësuar dhe nënshkruar paraprakisht nga autoritetet doganore në përputhje me pikat (a) dhe (b).

(a) Kur eksporti i mallrave nuk ka nxjerrë në pah plotësimin e formaliteteve doganore të eksportit me synimin e rikthimit të pagesave ose shumave të tjera të sigurara për një eksport sipas masave të politikës bujqësore, ajo kuti do të mbajë shënimin e mëposhtëm:

— Asnjë rikthim pagese ose shuma të tjera që jepen në eksport.

(b) Kur eksporti i mallrave nxjerr në pah plotësimin e formaliteteve doganore të eksportit me synimin e rikthimit të pagesave ose shumave të tjera të siguruar për një eksport sipas masave të politikës bujqësore, kutia duhet të mbajë shënimet e mëposhtme:

— Rikthimi i pagesave dhe shuma të tjera në eksport të paguara për ... (sasia),

ose

— E drejta për rikthimin e pagesave ose shumave të tjera në lidhje me eksportin anulohet për (sasia),

varur në faktin nëse pagesat apo shumat e tjera të siguruar në eksport janë ose jo paguar ndërkohë nga autoritetet përgjegjëse.

Shtoni datën, vendin dhe nënshkrimin.

(3) Kutia C: Kur duhet të lëshohet një kopje e Fletës së Informacionit INF 3, duhet të përmbajë një nga treguesit e më poshtëm:

DUBLIKATE

Shtoni datën, vendin dhe firmën.

(4) Kutia D: Emri i plotë dhe adresa e zyrës doganore të eksportit

(5) Kutia E: Kërkesë nga zyra doganore për ri-import Tregoni përmbajtjen e kërkesës si më poshtë:

(a) verifikim i autenticitetit të kësaj flete Informacioni dhe saktësia e informacionit që përmban,

(b) informacione të tjera për tu dhënë (të detajuara).

Tregoni si më poshtë:

(a) emrin e plotë dhe adresën e zyrës doganore të ri-importit,

(b) data, vendi dhe firma.

(6) Kutia F: Përgjigja e autoriteteve kompetente

Tregoni përmbajtjen e përgjigjes si më poshtë:

(a) konfirmimi i autenticitetit të kësaj flete Informacioni dhe të saktësisë së informacionit që përmban,

(b) informacion tjetër i dhënë (I detajuar),

(c) komente shtesë.

Tregoni të mëposhtmen:

(a) emrin e plotë dhe adresën e autoriteteve kompetente,

(b) data, vendi dhe firma.

(7)Kutia G: Ri-importi

Zyra doganore e ri-importimit do të regjistrojë në fletën e informacioni INF 3 sasinë e mallrave të kthyer të përjashtuar nga tarifa e importit. Kur kjo bëhet në letër, ajo zyrë do të mbajë origjinalin dhe do të dërgojë kopjen, e cila mban numrin e referencës dhe datën e deklaratës për qarkullim të lirë, autoriteteve doganore që e kanë lëshuar atë.

Autoritetet doganore ne fjalë do të krahasojnë këtë kopje me atë që kanë dhe do ta mbajnë atë në dosjet e tyre zyrtare.